REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA E KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Datë:26/10/2026 Nr. 02/ 1101

Në mbështetje të neneve 13, 17, 24 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Formohet Komisioni për Inventarizimin e pasurisë jofinanciare për vitin 2026 për njësinë buxhetore – ShFMU "Lasgush Poradeci" – Muzeqinë.
2. Anëtarët e komisionit sipas pikës 1 të dispozitivit caktohen:
   - Muhamet Halimi – kryesues;
   - Burim Bibaj – anëtar;
   - Delator Qorrolli – anëtar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe zhvillohen në pajtim me Rregulloren nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizata Buxhetore.
4. Konkretisht, detyrat dhe përgjegjësitë sipas pikës paraprake të dispozitivit përfshijnë:
   a) Inventarizimin e të gjithë pasurisë jofinanciare që është në pronësi dhe nën kontroll të komunës së Shtimes;
   b) Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jofinanciare;
   c) Krahasimin e gjendjes faktike të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jofinanciare;
   d) Identifikimin e pasurive jofinanciare të dëmtuara dhe atyre jashtë përdorimit;
   e) Përgatitjen e raportit për procesin e inventarizimit;
   f) Hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jofinanciare deri më 11/01/2027
5. Raportet dhe dëshmitë e procesit duhet të dorëzohen te Komisioni Komunal për Inventarizim që të përgatitet Raporti Përfundimtar i Pasurisë Jofinanciare.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:
Menaxhmentit të Komunës
Arkivit

Qemajl Kliu
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA E SHTIMES · OPŠTINA ŠTIMLJE · SHTIME-ŠTIMLJE